REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 814/22, 10/23
Datë/Datum. 19.01.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli *Ekspert shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit* *10.11.01.2023*	*Data e dorëzimit të raportit* *19.01.2023*	*Nr. i lëndës:* *814-22-10-2023*
MBedrolli			

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 28.12.2022, grupi i operatorëve ekonomik **"Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group",** ka parashtruar ankesë me nr: **814/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik **"Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i pendes ne fshatin Vranoc",** me nr.të prokurimit: **635-22-6769-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Pejes.

Me datën: 04.01.2023, grupi i operatorëve ekonomik **"VB TOFAJ" SH.P.K,** ka parashtruar ankesë me nr: **10/23,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik **"Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i pendes ne fshatin Vranoc",** me nr.të prokurimit: **635-22-6769-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Pejes.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur- punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 317 964,00 €

B05 Njoftimi për Kontratë - 06.07.2022

Procesverbali i Hapjes së Ofertave 26.07.2022

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së - 01.08.2022

Njoftimi mbi vendimin e AK-së (Rivlerësim) - 11.08.2022

Vendimi i OSHP - 23.11.2022

Njoftimi i vendimit të AK -12.12.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Pretendimet e grupi të operatorëve ekonomik "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group", me nr. ankesë me nr: 814/22,

OE ankues pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe Ligji për Shoqëri Tregtare siç janë:

Ligji i Prokurimit Publik

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- 108A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Ligji për Shoqëri Tregtare

- Neni 19 Numri unik identifikues
- Neni 23 Detyrimi për Regjistrim
- Neni 45 Çregjistrimi

I. KRONOLOGJIA E FAKTEVE

1.1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës me datë 06.07.2022 ka publikuar njoftimin për kontratë me të

cilin ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull Ndërtimi i pendës në fshatin Vranoc. Vlera e parashikuar e projektit ishte 317,964.00 Euro, procedurë e hapur, punë ndërtimore.

1.2. Me datën 26.07.2022 është bërë hapja dhe leximi i çmimeve të ofruara nga operatorët ekonomik, nga ku është vërejtur se janë dorëzuar pesë (5) oferta nga pesë konsorciume të ndryshme të operatorëve ekonomik.

1.3. Me datë 01.08.2022 është bërë Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, ku AK Komuna e Pejës ka rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik Ridvan Elezi B.I., Menti Sh.p.k. Në lidhje me këtë vendim janë dorëzuar kërkesa për rishqyrtim për shkak të shkeljeve që ishin bërë në vlerësim të ofertave.

1.4. Me datë 11.08.2022 Komuna e Pejës ka publikuar njoftimin mbi Rivlerësimin e ofertave me anë të së cilës kishte rekomanduar për dhënie të kontratës grupin e operatorëve Grup i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË.

1.5. Operatorët ekonomik të pakënaqur me këtë vlerësim për shkak të shkeljeve ligjore sërish kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe ankesa në OSHP. Të njëjtat janë aprovuar nga OSHP dhe lënda është kthyer në rivlerësim përsëri.

1.6. Me datë 12.12.2022 Autoriteti Kontraktues bënë rivlerësimin e ofertave dhe publikon edhe njëherë Njoftimin mbi Vendimin e AK me të cilën rekomandon për dhënie të kontratës Grupin e Operatorëve Ekonomik Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K.; EAE-NJAZ SH.P.K.. Në këtë formë Komuna e Pejës pa shikuar fare të dhënat e përshtatshmërisë së operatorit ekonomik rekomandon për dhënie të kontratës një konsorcium të cilit lideri i konsorciumit Lulzim Beqiraj B.I. është biznes i shuar sipas të dhënave publike të ARBK-së.

1.7. Me datë 19.12.2022, Ankuesi paraqet Kërkesë për rishqyrtim pranë AK Komuna e Pejës, për shkak të shkeljeve të cilat janë bërë me rastin e rivlerësimit dhe që kërkuar nga AK Komuna e Pejës që të aprovoj kërkesën për rishqyrtim dhe çështjen ta kthej në rivlerësim, ta shpallë të papërgjegjshëm grupin e operatorëve Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K.; EAE- NJAZ SH.P.K., dhe të kërkoj nga OSHP që të njëjtit të futen në listë të zezë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

1.8. Në Kërkesën për rishqyrtim është dhënë një arsyetim i thukët se përse e njëjta duhet të aprovohet si dhe cilat dispozita janë shkelur kur AK publikon Njoftimin mbi Vendimin me të cilin e rekomandon për dhënie të kontratës Grupin e Operatorëve Ekonomik Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K.; EAE-NJAZ SH.P.K.

1.9. Ankuesi si shkelje thelbësore dhe të patejkalueshme i ka listuar shkeljet e dispozitave të neneve 7, 68 dhe 69 të Ligjit të Prokurimit Publik dhe neneve 19, 23 dhe 45 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, krejt kjo për

shkak se AK nuk ka vlerësuar dokumentet e OE të rekomanduar, duke rekomanduar një operator ekonomik i cili sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve dhe Administratës Tatimore të Kosovës është i shuar që nga data 24.11.2022.

1.10. Në kërkesën për rishqyrtim janë ngritur edhe pretendimet ankimore në lidhje me mundësinë e dështimit se kompania, lideri i koncorciumit ka certifikatë të regjistrimit të biznesit pasi që i njëjti tani evidentohet si i shuar në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve.

1.11. Gjithashtu për të bërë te besueshme pretendimet ankimore, ankuesi në cilësinë e provës, i bashkangjet kërkesës për rishqyrtim linkun në ARBK, ku evidentohet që OE Lulzim Beqiraj B.I, evidentohet si i shuar. Gjithashtu si pretendim në kërkesën për rishqyrtim është ngritur çështja e nënshkrimit të kontratave të cilat janë të nënshkruara nga Durim Beqiraj, person ky që sipas të dhënave nuk ka pasur asnjë pozitë në kompaninë Lulzim Beqiraj B.I. dhe as nuk ka qenë përfaqësues i autorizuar e as drejtor.

1.12. AK me datë 22.12.2022, nxjerrë Vendim në lidhje me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit, me të cilin vendim refuzon Kërkesën për rishqyrtim dhe vërteton Vendimin e AK mbi B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK (rivlerësim) të publikuar me datë 12.12.2022.

1.13. Në vendimin e AK të ankimuar nuk është trajtuar asnjë pretendim ankimor i paraqitur në kërkesën për rishqyrtim dhe AK ka deklaruar së të njëjtit kanë ardhur në përfundim se kërkesa e paraqitur është e pabazuar pa dhënë asnjë arsyetim në lidhje me pretendimet e ankuesit, me pretendimin se kanë zbatuar në tërësi Vendimin e Panelit Shqyrtues pranë OSHP-së.

II. BAZA LIGJORE

II. 1. Ligji për Prokurimin Publik ka përcaktuar në Nenin 7 Parimin e Barazisë në trajtim dhe mos diskriminimin në të cilin thuhet: "7. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik[...]Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat

për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse. "

II.2. Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale thuhet: "Kur një operator ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike duhet të regjistrohet në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në mënyrë që të zbatojë aktivitetet për të cilat një regjistrim i tillë kërkohet, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend. Regjistri komercial nuk kërkohet në rastet e organizatave të shoqërisë civile."

II.3. Ligji për Prokurimin Publik i ndryshuar në nenin 108 A, në paragrafin 12, parasheh që "Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë". Vendimi i ankimuar i AK nuk përmban fare arsyetim me asnjërin nga pretendimet e ngritura nga OE ankues. AK ka dështuar që të zbatoj edhe dispozitën e nenit 56 [Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave], cila dispozitë parasheh vlerësimin e tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

II.4. Ligji për Shoqëritë Tregtare në Nenin 19 Par. 1 ka parashikuar: "Neni 19 Numri Unik Identifikues 1. Me rastin e regjistrimit fillestar, Shoqërisë Tregtare ose subjekti tjetër i përcaktuar në nenin 23 të këtij ligji i lëshohet Numri Unik Identifikues i cili shërben njëkohësisht si numër për identifikimin e Shoqërisë Tregtare për qëllime të regjistrimit dhe për qëllime tatimore, si dhe për qëllime të tjera të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria sipas paragrafit 2 të këtij neni. "

II.5. Për më tepër me Nenin 45 Par. 7 thuhet: "Me përfundimin e procedurave të parapara për çregjistrimin e Shoqërisë Tregtare apo subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në ARBK, ARBK i lëshon palës apo palëve një Vendim për Çregjistrim. "

III. AUTORITETI KONTRAKTUES KA SHKELUR LIGJIN DUKE SHPALLUR FITUES NJË KOMPANIINEKZISTENTE

III. 1. Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar me moskujdes të shtuar, pasi që ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator i cili sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve është i shuar që nga data 24.11.2022.

III.2. Një kompani e shuar, nuk mund të hyjë në raporte kontraktuale me një autoritet publik apo privat, pasi që e njëjta më tutje nuk ekziston si subjekt juridik për nevojat e Ligjit për Shoqëri Tregtare dhe rrjedhimisht nuk mund të quhet operator ekonomik sipas kritereve të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

III.3. Në përputhje me procedurat e prokurimit, lideri i konsorciumit, në këtë rast kompania Lulzim Beqiraj B.I. nuk mund të dëshmoj se ka certifikatë regjistrimi, pasi që e njëjta tanimë është çregjistruar me vendim të ARBK, nuk mund të dëshmoj se nuk është në procedurë falimentimi, pasi që e njëjta nuk ekziston më dhe nuk mund të dëshmoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë. I njëjti operator nuk ka se si të nënshkruaj apo zbatoj një kontratë publike në cilësi të biznesit të shuar.

III.4. Se biznesi është i shuar është vërtetuar në mënyrë të pamohueshme nga ana e ARBK e kjo gjë mund të verifikohet në mënyrë të lehtë nga Autoriteti Kontraktues përmes ueb faqes përkatësisht linkut https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id= 1,38,3479. Foto nga ueb faqja e ARBK është bashkangjitur si aneks kësaj Ankese. Rrjedhimisht i njëjti për shkak se nuk ka njoftuar AK për shuarjen e biznesit, duhet të futet në listë të zezë të gjithë anëtarët e këtij konsorciumi.

III.5. Sipas informacioneve që kemi mundur të marrim nga vet Autoriteti Kontraktues ky konsorcium mund të mos ketë validitet të ofertës dhe sigurim të ofertës të pashkëputur siç kërkohet me legjislacionin e prokurimit publik. Andaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues dhe OSHP të verifikoj edhe njëherë këtë çështje dhe të sigurohet se ekziston validitet i pashkëputur i operatorit ekonomik.

III.6. Të gjitha kontratat me nënshkruesit janë të nënshkruara nga Durim Beqiraj person i cili nuk ka dorëzuar autorizim se e ka këtë të drejtë për të nënshkruar kontrata dhe i njëjti sipas të dhënave në ARBK nuk është as drejtor dhe as përfaqësues i autorizuar, në çfarëdo forme për të bërë nënshkrime të tilla. Rrjedhimisht kontratat nuk mund ti merren për bazë përderisa janë nënshkruar nga një person i paautorizuar në bazë të ligjit apo

autorizimit noterial.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha ato çfarë u thanë më lartë i kërkojmë Paneli Shqyrtues pranë OSHP-së që të Aprovoj këtë ankesë dhe këtë lëndë ta kthej në rivlerësim pranë AK- së, me rekomandim që ta shpallë të papërgjegjshëm grupin e operatorëve Lulzim Beqiraj B.L; FIDANI-BETON SH.P.K.; EAE-NJAZ SH.P.K., dhe OSHP të njëjtin ta fut në listë të zezë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Pretendimet e grupi të operatorëve ekonomik VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK, me nr. ankesë me nr: 10/23.

OE ankues pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Ligji Nr. 04/1.-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin 05/L- 068 dhe Ligjin 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), si vijon:

1. Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes paragrafi 1 dhe 2,
2. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 4,
3. Neni 67 Provat Shkresore paragrafi 1 dhe 2

Si dhe Rregullore Nr. 001/2022 për prokurimin publik

1. Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 40.1,40.2 si dhe paragrafi 40.6

Fleta e të dhënave të tenderit: Neni 7.1& 7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale.

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt: 06.07.2022

Afati për dorëzimin e ofertave / kërkesës për pjesëmarrje dt: 26.07.2022

Procesverbali i hapjes së ofertave dt: 26.07.2022,

Njoftimi mbi vendimin e AK dhe Letra Standarde dt: 01.08.2022

Kërkesë për qasje ne dokumente dt: 03.08.2022

Përgjigje për qasje ne dokumente dt: 03.08.2022

Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit dt: 08.08.2022

Njoftimi mbi vendimin e AK dhe Letra Standarde Rivlerësim dt: 11.08.2022

Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit dt: 17.08.2022

Vazhdimi i validitetit dhe sigurimit te ofertave dt: 18.10.2022

Pjesa C formular për vazhdimin e validitetit dt: 18.10.2022

Njoftimi mbi vendimin e AK dhe Letra Standarde Rivlerësim dt: 12.12.2022

Kërkesë për qasje ne dokumente dt: 13.12.2022

Përgjigje për qasje ne dokumente dt: 13.12.2022

Kërkesë për rishqyrtim te vendimit dt: 16.12.2022

Vendimi i AK në kërkesën për rishqyrtim dt: 27.12.2022

Kriteret për dhënie të kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin me te ulët

Pretendimi 1. Tregon shkeljet e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 40.1 ku thuhet: "Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP" po ashtu paragrafi 40.2 "Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri- vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar", si dhe paragrafi 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit".

Ku pas verifikimit të dokumenteve kemi parë se Grupi i OE të propozuar për dhënie të kontratës konkretisht Lideri i Grupit OE Lulzim Beqiraj B.I me Emer tregtar N.T.P "FIDANLL" ka shuar biznesin në kohen ku ka qenë në vlerësim e që një gjë e tillë bënë shkelje të ligjeve të lartcekuara duke kaluar nga Biznesi individual ne atë shpk.

Pra gjatë hulumtimit tonë kemi gjetur se Grupi i OE në fjalë figuron të jetë i shuar me datë 24.11.2022, kompani kjo që ka menduar të nënshkruaj kontratë me AK duke qitur ne lajthitje, dhe duke mashtruar AK, me një firmë e cila tashmë nuk ekziston, madje me paramendim, sepse shuarja e një biznesit nuk ndodhe brenda një dite por

parashikohet me herët.

Për kundër faktit se është shpallur fitues, prapë OE nuk ka informuar AK, duke tentuar të përdorë një biznes tjetër si SHPK.

Ne kemi verifikuar në ARBK dhe në ATK dhe për këtë po ju ofrojmë dëshmi ku tregon se biznesi me NUI: 810215394 ne emër të LULZIM BEQIRAJ B.I është shuar me datën: 24.11.2022, dhe ne po të njëjtën datë është hapur biznesi i ri me NUI: 811990177 ne emër FIDANIL SH.P.K, për të mashtruar me nënshkrim kontrate.

Firma me të cilin kanë aplikuar në këtë procedurë i bie se që asnjë lëvizje, asnjë aktivitet nuk mund të ushtrojë nga data 24.11.2022.

Kërkojmë nga ana juaj të merrni masa ndaj këtij rasti, të eliminoni në mënyre automatike dhe se kompania jonë plotëson kushtet për këtë kontratë dhe ne duhet të shpërblehemi me të.

OE i lartpërmendur të eliminohet dhe të merren masa ndaj tyre për këto mashtrime sepse OE ka mashtruar edhe gjatë fazës së ankimimit në OSHP, duke mos informuar për shuarjen e biznesit.

Bashkangjitur gjeni dëshmitë që tregon se ka ndryshim te NUI dhe atë të TVSH me të cilin ka aplikuar dhe atë të cilën e posedon tani.

Të gjitha këto mashtrime dhe ndryshime po bëhen gjatë procesit të vlerësimit, e që janë të ndaluara rreptësishtë me ligjin e lartcekur.

Pretendimi 2. Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes paragrafi 1 ku thuhet: "Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator I interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose procedurave konkurruese me negociata, për të pranuar një

ftesë për tenderim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji". Ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni thotë: "Autoriteti kontaktues duhet: (i) të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundshme, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje; dhe (ii) të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit, të gjitha dokumentet dhe informatat në fjalë. Të gjitha këto

kërkesa për dokumente dhe informata do të kufizohen vetëm në aq dokumente dhe informata sa është e nevojshme për ti lejuar autoritetit kontraktues që të verifikojë se operatori përkatës ekonomik: (i) nuk konsiderohet i papërshtatshëm sipas nenit 65 të këtij ligji, dhe (ii) nëse aplikohet, i përmbush kriteret minimale të përzgjedhjes të saktësuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në asnjë rast njoftimi i kontratës ose dosja e tenderit nuk do të kërkojnë nga operatori i interesuar ekonomik që të dorëzojë dokumente ose informata që nuk kërkohen ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65-70 të këtij ligji".

Autoriteti Kontraktues ka sqaruar në detaje çdo kërkesë e cila duhet të plotësohet nga OE për të qenë i përgjegjshëm, prandaj dokumentet të cilat ne kemi marrë pas kërkesës për qasje me pranimin e njoftimit mbi vendimin e AK, aty mungojnë ISO 14001:2015 e cila është me afat të skaduar nuk është paraqitur ISO me validitet siç e pretendon OE ku thotë se ka vazhdu validitetin e ISO 14001:2015 prej (dt: 17.08.2022 - 16.08.2023 me datë ricertifikimi 17.07.2025).

Ne nuk e kemi parë këtë ISO me validitetin siç thuhet po ashtu nëse mund të na tregoj periudha prej dt: 02.08.2022 deri 16.08.2022 nuk ka qenë valide (pra nuk ka vlefshmëri) sepse kjo ISO është vazhduar siç u cek me lartë.

Pretendimi 3. Ku pas verifikimit të dokumenteve kemi parë se Grupi i OE të propozuar për dhënie të kontratës nuk ka prezantuar zgjatjen e validitetit të ofertës dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit si dhe plotësimin e Formularit C ashtu siç kërkohet në shkresën e AK të dërguar me datë: 18 tetor 2022.

Pretendimi 4. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve paragrafi 4 ku thuhet: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ku është kërkuar: "Kamion vet shkarkues minim 10 m3. minimum 4 cope, si dëshmi është kërkuar: Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj).

Vëmendje!

Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar - e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit. Dëshmitë për pajisjet duhet të ofrohen të renditura sipas listës së bashkangjitur në Aneksin 1. Gjithashtu, dëshmitë duhet të jenë të dukshme.

Vërejtje

Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet "

Kamioni i prezantuar me numër të regjistrimit 07-514-DI gjatë periudhës së vlerësimit ka skaduar validiteti prandaj nuk është prezantuar regjistrimi i ri.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat e përshtatshmërisë: **a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **a).Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosijen e tenderit. b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.**
Përshtatshmëria profesionale: **Kërkesa 1. Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK)** **Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH –së**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1** **Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje** **Evidenca 2** **Certifikata e TVSH-së kopje**

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **Kërkesa 1** **Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjat tre vite të fundit financiare duhet te jet jo më pak se 630.000.00 Euro.** **Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1** **Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiare për tri vitet të fundit**	
Kapaciteti teknik dhe professional: **Kërkesa 1** **Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të <u>ngjajeshme (Penda)</u> në vler prej 400.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat.** **Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 1** **Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, <u>datën e përfundimit dhe</u> përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve.**	
Kërkesa 2 **Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale.** **– Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt - minimumi 10 punonjës**	**Dëshmia 2** **Lista e punëtoreve me kontrata ose para kontrata ne emer te keti projekti minimum 10 punëtorë.**	
Kërkesa 3	**Dëshmia 3**	

Menaxheri i projektit Inxhinieri i diplomuar i ndërtimtaris ose master drejtimi konstruktiv me kontrat apo parakontrat ne emer të projektit- me provoj pune minimum 3 vjeqare.	Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te ket Diplomen-kopje , vendim për Projektmenagjer i vulosur dhe nenshkruar nga Kompania si dhe CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri .
Kërkesa 4 Stafi i lartë profesional që do të kyqet në projekt minimum 1 inxhinerë –Nje Inxhinjer i diplomuar i Hidros (ose master) me kontrat apo parakontrat ne emer te projektit minimum 3 vite përvoj pune,pas diplomimit.	Dëshmia 4 Për stafin professional (inxhinieri) duhet te ket Diplomen – kopje, kontrat apo parakontrat ne emer te projektit dhe CV-ja e nenshkruar nga vet inxhinjeri.
Kërkesa 5 Operatori ekonomik (ne rast te Grupit te OE , se paku njeri antar i grupit) duhet të deshmoj se sistemi menaxhues i ofertuesit permbush kriteret e percaktuara ne fushen e ndertimtaris se pako per keto ISO standard -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimin Mjedisor	Dëshmia 5 Operatori Ekonomik duhet të jetë i paijisur me Certifikatat ISO valide (kopje) Vrejtje Çertifikatat e natyres se njejt ISO më të avansuara pranohen
Kërkesa 6 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1. Kamion vet shkarkues minim 10 m3. minimum 4 cope 2. Eskavator minimum 8 tone Minimum 2 cope 3. Cilinder , minimum 1 cope	Dëshmia 6 Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për

	marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit. Dëshmitë për pajisjet duhet të ofrohen të renditura sipas listës së bashkangjitur në Aneksin 1. Gjithashtu, dëshmitë duhet të jenë të dukshme. **Vërejtje** **Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet**	
Kërkesa 7 **Baza për prodhimin e Betonit e licencuar,në pronesi,apo marrëveshje për furnizime me Beton me nje OE te licencuar.**	**Dëshmia 7** **Licenca valide (të skanuara nga origjinali ose kopje e noterizuar) të lëshuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale apo marrëveshje për furnizim me beton me një operator të licencuar nga KPMM. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit.**	
Kërkesa 8 **Specifikimi teknik i detyrushëm**	**Dëshmia 8** **Deklarat e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K**	

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 12.12.2022, është konstatuar si në vijim: AK-Komuna e Pejës, shpërblen me kontratë grupin e operatorëve ekonomik **"Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk** me vlerë totale të ofertës 295,864.00 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME PSH-së LIDHUR ME RASTIN

PSH.nr. 381-395-398-2022
i dt.23.11.2022

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues - Komuna e Pejës ka zbatuar procedurë të hapur - punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 317 964,00 €

Fillimisht sqarojm se kjo procedurë e prokurimit ka qene objekt i shqyrtimit ne OSHP, rrjedhimisht disa nga pretendimet ankimore tani veq i kemi trajtuar, ku kemi nxjerr raport të ekspertizës Nr.381-395-398/2022. Poashtu edhe Paneli Shqyrtues i ka gjykuar me Vendimin **PSH.nr.381-395-398/2022** të datës **23.11.2022.**

Me qëllim të sqarirmit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, në vijim do të japim një sqarim të shkurtër sipas kronologjisë së kësaj lënde. Pas vlerësimit të ofertave në herën e parë nga autoriteti kontraktues - Komuna e Pejës, sipas formularit B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës **01.08.2022, AK** ka rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik **"Alfa-Ing" Ridvan Elezi B.I &" Menti" shpk** në vlerë totale të ofertës: 249 512,50 euro.

Pas ri vlersimit të ofertave, AK me datë **11.08.2022** nxjerr Njoftim mbi vendimin e AK-së, duke e rekomanduar për kontratë grupin e **OE VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK** me çmim të tenderit 300,300.30 euro.

Pastaj, pas ankesave të parashtruara në OSHP, Panelit Shqyrtues nxjerr vendimin **PSH.nr.381-395-398/2022 të datës 23.11.2022,** duke e kthyer këtë aktivitet të prokurimit në ri vlerësim. Pas kthimit të lëndës në ri vlerësim, AK sipas formularit B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës **12.12.2022,** shpërblen me kontratë grupin e operatorëve ekonomik **"Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk** me vlerë totale të ofertës 295,864.00 euro.

Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) të grupit të operatorëve ekonomik "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group", me nr. ankesë me nr: 814/22 dhe VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK me nr. ankesë me nr: 10/23

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes sqarojmë se pretendimet ankimore të parashtruesve te

ankesave kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik "Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk. Po ashtu, ankesat janë parashtruar edhe për mos respektim te dispozitave të LPP-së dhe Ligji për Shoqëri Tregtare dhe procedurës se prokurimit nga ana e Autoritetit Kontraktues Komuna e Pejës.

Më poshtë, do ti trajtojmë si pretendime të përbashkëta ato pika ankimore të cilat janë të njëjta në të dy ankesat.

1. **Pretendim i OE ankues "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group"**

Lidhur me pretendimin e OE ankues **"Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group"**, se AK nuk e ka arsyetuar dhe nuk i ka trajtuar asnjë nga pretendim ankimore kundrejt kërkesës për rishqyrtim të datës 19.12.2022, ashtu siç parashihet me nenin 108/A të LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues me datë 19.12.2022 ka parashtruar kërkese për rishqyrtim me pretendime ankimore kundrejt ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduara për kontratë dhe shkeljeve të autoritetit kontraktues. AK përmes vendimit të datës 22.12.2022 kundrejt kërkesës për rishqyrtim nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore përkundër faktit që parashtruesi i ankesës ka kërkuar një gjë të tillë përmes kërkesës për rishqyrtim të datës 19.12.2022. Mos trajtimi i pretendimeve ankimore apo mos dhënia e përgjigjeve në pretendime ankimore nga AK Komuna e Pejës është në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, përkatësisht paragrafin 8, 9 dhe 12 të këtij neni. Sipas kësaj dispozite ligjore, përveç tjerash, AK është e obliguar të përgjigjet në pretendime ankimore dhe ti trajtoj kërkesat/pretendimet e ankuesit. Andaj pretendimi i OE ankues është i **qëndrueshëm**.

2. **Pretendim i OE ankues "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group"**

Lidhur me pretendimin e OE ankues **"Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group"**, se të gjitha kontratat e OE të rekomanduar për kontrata **"Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk** janë të nënshkruara nga Durim Beqiraj person i cili nuk ka dorëzuar autorizim se ka këtë të drejtë për të nënshkruar kontrata dhe i njëjti sipas të dhënave në ARBK nuk është as drejtor dhe as përfaqësues i autorizuar, në çfarëdo forme për të bërë nënshkrime të tilla. Rrjedhimisht kontratat nuk mund ti merren për bazë përderisa janë nënshkruar nga një person i paautorizuar në bazë të ligjit apo autorizimit noterial.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 2 **Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë**	**Dëshmia 2**

projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. **– Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt - minimumi 10 punonjës**	**Lista e punëtoreve me kontrata ose para kontrata ne emer te keti projekti minimum 10 punëtorë.**

Lidhur me këtë kërkesë **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar që *"Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. – Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 10 punonjës"*

Ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare ka kërkuar:

"Lista e punëtoreve me kontrata ose para kontrata ne emër te këtij projekti minimum 10 punëtorë" askund nuk është kërkuar që kontratat ose para kontrata e lidhura me punëtor duhet ti nënshkruaj ndonjë person përgjegjës i kompansë. Megjithatë, bazuar në shkresat e lëndës personi i cili i ka nënshkruar këto kontrata me punëtor ne emër të këtij projekti si punëdhënës është në cilësinë e menaxherit në bazë të dokumenteve.

<u>Prove:</u>

Punëdhënësi:
NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I)
Përfaqësuar nga :
DURIM BEQIRAJ - Menaxher

Nënshkrimi

Punëmarrësi:
EMRI MBIEMRI
I Punësuari :
Demë Loshaj

Nënshkrimi

3. **Pretendim i përbashkët OE "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group",** dhe **"VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK"**

Lidhur me pretendimin **e njejtë të operatorëve** ekonomik ankues **"Engineering Group sh.p.k. & Çeta – General Invest Group",** dhe **"VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK"** se AK ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik, ku lideri i konsorciumit **Lulzim Beqiri B.I** me emër tregtar **N.T.P "FIDANI- L"** me numër të biznesit **NUI:810215394** ka shuar biznesin në kohën derisa ka qenë në vlerësim, duke kaluar nga **biznesi individual në atë shpk.** Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve dhe të ATK, rezulton se ka shuar biznesin me datë:24.11.2022. Ndërsa po me te njëjtën datë 24.11.2022 ka hap biznesin e ri me **NUI:811990177** me emër **"FIDANI L" SHPK**. Me tej, operatorët ekonomik ankues shtojnë se një kompani e shuar nuk mund të hyjë në raporte kontraktuale me një autoritet publik apo privat pasi që e njëjta nuk ekziston si subjekt juridik për nevojat e Ligjit për Shoqëri Tregtare dhe rrjedhimisht nuk mund të quhet operator ekonomik sipas kritereve të përcaktuara me LPP-në. Firma me të cilën kanë aplikuar në ketë procedur i bie që asnjë lëvizje, asnjë aktivitet nuk mundë të ushtroj nga data 24.11.2022. Tutje, OE ankues kërkojnë që i njëjti dhe i gjithë konserciumi të futet në listën e zezë për shkak të mashtrimit dhe ndryshimit gjatë procesit të vlerësimit.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se grupi i OE të rekomanduar për kontratë **"Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk** në ofert ka bashkangjitur dokumentin me titull: **PENDA NE FSHATIN VRANOC PJ 2.pdf,** ku në faqe 14 gjendet Marrëveshje Mirëkuptimi për Themelimin e Partneritetit (Konsorciumit). Kjo marrëveshje për themelimin e partneritetit është lidhur në mes të **NTP FIDANI-L** (Lulzim Beqiraj B.I) në cilësi të liderit dhe **FIDANI-BETON SHPK** dhe **EAE-NJAZ SHPK**. Pra në këtë marrëveshje ceket se lideri i grupit është **NTP FIDANI-L** (Lulzim Beqiraj B.I).

Po ashtu, grupi i OE të rekomanduar për kontratë **"Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz" shpk** me ofertë kanë bashkangjitur edhe dokumentet si certifikatat e regjistrimit të biznesit nga ARBK.

Sa i përket se pretendimit se sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, lideri i konserciumit Lulzim Beqiri B.I e ka shuar biznesin me datë 24.11.2022, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se hulumtimit në faqen zyrtare të ARBK-së, rezulton se anëtari i grupit/lideri **NTP FIDANI-L** (Lulzim Beqiraj B.I) me **NUI 810215394** është shuar me datë **24.11.2022**. Më posht paraqesim pjesën e shkëputur të informatave nga ARBK për biznesin **NTP FIDANI-L** (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394, në të cilën tregohet data e shuarjes së këtij biznesi:

Lulzim Beqiraj B.I.

Emri i biznesit	Lulzim Beqiraj B.I.
Emri tregtar	N.T.P. "Fidani-L"
Lloji biznesit	Biznes individual
Numri unik identifikues	810215394
Numri i biznesit	80411901
Numri fiskal	600040935
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	64
Data e regjistrimit	14/03/2001
Komuna	Deçan
Adresa	Baballoq, Arben Qerimaj Nr.180
Telefoni	049/457-432
E-mail	///
Kapitali	€
Statusi në ARBK	Shuar
Data e shuarjes	24/11/2022
Statusi në ATK	///

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Lulzim	Beqiraj	Agj. i Regjistruar	

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Lulzim Beqiraj	€	%

Njësitë

Megjithatë, për të vërtetuar nëse ky biznes është shuar apo i është ndryshuar lloji i "biznes individual" në llojin e biznesit "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", ekspertja shqyrtuese me datë 16.01.2023 i është drejtuar ARBK-së me kërkesë për të dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me shuarjen apo ndryshimin e llojit të biznesit. ARBK me datë 18.01.2023 ka kthyer përgjigje, ku sipas kësaj përgjigje rezulton që subjekti apo lideri i grupit NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394 është shuar me datë 24.11.2022. Më poshtë është shkëputur përgjigja e ARBK-së:

Sent 1/18/2023 2:54 PM

Info Arbk

RE: Kërkesë për verifikim të informatës!

To Majlinda Bedroši

Cc Arbëri Bytyqi; Vjosa Gradinaj; Shqipe Hoti

Retention Policy DelFiveYOldEm (5 years) Expires 1/17/2033

E nderuar,

Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 80411901 , me zbatimin e ligjit për numrin unik te identifikues te biznesit ka këtë numër NUI: 810215394 Me datën: 24-11-2022 ky biznes shuhet për shkak të ndërrimit të tipit në 'Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara' SH.P.K. dhe merr numër të ri të biznesit 811990177 dhe me këtë numër vazhdon veprimtarinë si biznesi i ri.

Me respekt.

Pra, duke pasur parasysh përgjigjen zyrtare të ARBK-së dhe tenderin e OE të rekomanduar për kontratë, ku si lider i konsorciumit ishte caktuar **NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I)** me **NUI 810215394,** ndërsa pas shuarjes së biznesit dhe hapjes së biznesit tjetër "FIDANI-L SH.P.K." me numër unik identifikues **811990177,** rezulton se lideri i grupit (NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) **me NUI 810215394)** ligjërisht është inekzistent. Në këtë kuptim, tani grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kërkesat e nenit 66.1 të LPP-së, siç potencohet:

66.1 *"Kur një operator ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike duhet të regjistrohet në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në mënyrë që të zbatojë aktivitetet për të cilat një regjistrim i tillë kërkohet,* ***autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend."***

Po ashtu AK në dosjen e tenderit përkatësisht tek pika 7.1 &7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale" ka kërkuar si në vijim:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale:** **Kërkesa 1.** **Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK)** **Kërkesa 2.** **Regjistrimi i TVSH –së**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1** **Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje** **Evidenca 2** **Certifikata e TVSH-së kopje**

Siç u dha sqarimi më lartë, shuarja e biznesit me të cilin ishte themeluar grupi i operatorëve ekonomik, tani më nuk i plotëson kërkesat e nenit 66 të LPP-së Përshtatshmëria Profesionale, sepse dorëzimi i deklaratës nën betim, marrëveshja për themelimin e konsorciumit dhe certifikata e ARBK-së, TVSH-së, etj, ishin plotësuar në emër të biznesit individual **NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I)** me **NUI 810215394.** Kurse, gjatë kohës së ri vlerësimit të tenderëve, lideri i këtij grupi kishte shuar biznesin dhe kishte hapur biznes të ri të llojit SH.P.K. (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar). Andaj, pretendimi e OE ankues e kualifikojmë si të qëndrushem.

4. **Pretendim i përbashkët OE "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group"**, dhe **"VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK"**

Lidhur me pretendimin **e njejtë të operatorëve** ekonomik ankues **"Engineering Group sh.p.k. & Çeta – General Invest Group"**, dhe **"VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK"** se grupi i OE të propozuar për dhënie të kontratës nuk ka prezantuar zgjatjen e validitetit të ofertës dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit si dhe plotësimin e Formularit C ashtu siç kërkohet në shkresën e AK të dërguar me datë: 18 tetor 2022. Me tej OE ankues potencojnë se ky konsorcium mund të mos ketë validitet të ofertës dhe sigurim të ofertës të pashkëputur siç kërkohet me legjislacionin e prokurimit publik. Andaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues dhe OSHP të verifikoj edhe njëherë këtë çështje dhe të sigurohet se ekziston validitet i pashkëputur i operatorit ekonomik.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se OE i rekomanduar kishte dorëzuar zgjatjen e validitetit të ofertës, vazhdimin e sigurimit të tenderit dhe plotësimin e Formularit C sipas kërkesës së Autoritetit kontraktues të datës 18 tetor 2022. Andaj Pretendimi është i pa qëndrueshëm.

<u>Provë:</u>

1. **Pjesa C: Formular për Dorëzimin e Tenderit**
2. **Deklaratë Konfirmimi e datës 19.10.2022 (Vazhdimi i validitetit)**

3.Siguria e Tenderit numri i polices: 060040010086363 (vazhdimi i sigurimit të ofertës)

Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) të grupit të operatorëve ekonomik VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK me nr. ankesë me nr: 10/23

Lidhur me pretendimin e 2 të OE ankues VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK që ka të bëjë me validitet të "Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimin Mjedisor". **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se pretendimin e cekur me lartë Paneli Shqyrtues e ka gjykuar me Vendimin **PSH.nr.381-395-398/2022** të datës **23.11.2022** dhe ky pretendim është "Res Judicata" sipas nenit 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit:

2. Eksperti i njëjtë shqyrtues, teknik ose profesional i prokurimit, nëse konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga paneli shqyrtues, e njofton me shkrim panelin shqyrtues dhe palet ne procedure lidhur me këto pretendime ankimore.

Lidhur me pretendimin e 4. të OE ankues VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK se kamioni i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me numër të regjistrimit **07-514-DI** gjatë periudhës së vlerësimit ka skaduar validiteti prandaj nuk është prezantuar regjistrimi i ri. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e paisjeve teknike, me gjithsej katër (4) kamion. Kamioni me numër rendor 4 me targa të regjistrimit **07-514-DI** në rastin e ofertimit kishte validitet për qarkullim rrugor deri me datë 30.08.2022 ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 26.07.2022. Pretendimi ankimor është i pa qëndrueshëm.

Provë



8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesat e operatorëve ekonomik ankues: "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group" me numër 814/22 dhe "VB TOFAJ" SH.P.K, me numër 10/23, të aprovohen si pjesërisht të bazuara, të anulohet propozimi për dhënie te kontratës dhe lënda të kthehet ne **Ri vlerësim.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues- Komuna e Pejes.

Panelit Shqyrtues - OSHP.

OE ankues - Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group,

OE ankues - VB TOFAJ SH.P.K